



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGISË  
BORDI

VENDIM

Nr.198, Datë 01.10.2021

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT GEK TERNA GROUP, PËR APLIKIM NË TAP AG PËR FAZËN JO TË DETYRUESHME NË TREG -TESTI I TAP AG, PËR KAPACITETIN DHE LIDHJEN E TERMOCENTRALIT ME CIKËL TË KOMBINUAR ME FUQI 160-180 MW NË ROSKOVEC FIER**

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 13; 15, pika 1, gërma “a”; 16, pika 24, 25; 17, pika 4; 19, pika 5 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; vendimit nr. 122, datë 11.05.2021, të bordit të ERE-s “Mbi miratimin e Propozimit të Projektit TAP, SRG dhe DESFA për Procesin e Rritjes të Kapacitetit për vitin 2019”; seksionit 4.7, pika 9, të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë”, Korrik 2013, si dhe Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 Maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas Direktiva 2009/73/EC nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 01.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.123/5 prot., datë 29.09.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi “Kërkesën e subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në treg -testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e Termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec, Fier”,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr. 910, datë 1 Shtator 2021, GEK Terna Group paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) “Kërkesën për aplikim nga GEK Terna Group, për fazën jo të detyrueshme në treg -testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e Termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec Fier”, në përputhje me nenin 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë dhe me Direktivën 2003/55/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 26 Janar 2003 lidhur me rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror.;
- TAP AG sipas neneve 4.1, pika 7 dhe 4.7, pika 2, 6 dhe 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, është e detyruar të plotësojë kërkesat për kapacitetin detyrues / lidhës të cilat rezultojnë nga çdo testim tregu.

- Referuar Njoftimit të fazës jo detyruese për testin e tregut TAP AG 2021, kërkesat nga palët e interesuara për lidhjet/kapacitetin jo detyrues duhet të paraqiten në TAP AG deri më datë 11 Tetor 2021.
- Faza jo detyruese e testimit të tregut për vitin 2021 nga Gazsjellësi Trans Adriatik ka filluar në 12 Korrik 2021. Testi i Tregut duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht me autoritetet rregullatore italiane (ARERA), Greke (RAE) dhe Shqiptare (ERE);
- GEK\_TERNA Group shprehet se është në fazën paraprake jo të detyrueshme të përcjelljes të njoftimit/kërkesës, për lidhjen dhe kapacitetin e gazit natyror pranë shoqërisë TAP AG dhe është në përputhje me parimet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, me Udhëzimet e Testit të Tregut, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.
- Duke qenë se aplikimi nga GEK TERNA Group është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzimet e Testit të Tregut, Kodi i Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit, ERE nuk ka kundërshtime për këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë *“Kërkesën e subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në Treg -Testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e Termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec Fier”* të paraqitur nga GEK Terna Group.
2. Drjësoria e Gazit Natyror të njoftojë subjektin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit AHMETI**